



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok.202002778/4

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2020

**Lënda:** *Rekomandohet dërgimi menjëherë për miratim në Këshillin e Ministrave i aktit nënligjor për aplikimet për dëmshpërblim të ish të dënuarit politik, për të cilin ka përfunduar shqyrtimi administrativ, rasti i ish të dënuarit politik Sh.H*

**Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë  
Z. Gentian Deva**

**Tiranë**

*I nderuar zoti Deva,*

Në institucionin e Avokatit të Popullit ashtu sikurse jeni në dijeni nëpërmjet komunikimit për trajtimin e rasteve, është regjistruar ankesa e shtetasit H.H, trashëgimtar i ish të dënuarit politik, Sh.H. Ky shtetas ka depozituar dokumentacionin e nevojshëm ligjor në Ministrinë e Drejtësisë, me qëllim përfitimin e dëmshpërblimit si trashëgimtar i ish të dënuarit politik, në zbatim të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 "Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist", i ndryshuar, konkretisht për dosjen nr.\*\*\*, datë \*\*.\*\*.\*\*\*\*.

Në Ministrinë e Drejtësisë edhe pse është regjistruar përkatësisht dosja individuale nr.\*\*\*, datë \*\*.\*\*.\*\*\*\*, rezulton se pas verifikimeve për këtë rast dosja në fjalë ende nuk është miratuar në asnjë nga 27 listat e VKM-ve për përfitimin e dëmshpërblimit financiar si e parashikon legjislacioni në fuqi.

Ne ju jemi drejtuar me shkresën nr.K2/H10-2, datë 05.11.2020 me anë të së cilës kemi kërkuar shpjegime lidhur me ecurinë e kësaj praktike dhe miratimin e saj me vendim të Këshillit të Ministrave, me qëllim vijimin e procedurave të mëtejshme të dëmshpërblimit.

Me shkresën tuaj nr.H-50/3 prot., datë 25.11.2020 për rastin e shtetasit Sh.H jeni shprehur se: Sa i përket problematikës që ka patur kjo dosje sqarojmë se qytetari është informuar paraprakisht se nga evidencat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ka rezultuar se nuk ka patur të dhëna për periudhën e dënimit të vuajtur nga Sh.H. Gjithashtu, ka rezultuar se edhe arkivat e institucioneve me të cilat Ministria e Drejtësisë bashkërendon punën nuk kanë patur asnjë të dhënë lidhur me periudhën e vuajtjes së dënimit për Sh.H.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.10037, datë 21.12.2015, vendosi: Pranimin e kërkesës dhe vërtetimin e faktit juridik të vuajtjes së dënimit nga i ndjeri Sh.H, duke përcaktuar si datë arrestimi \*\*.\*\*.\*\*\*\* dhe datë lirimi nga burgu \*\*.\*\*.\*\*\*\*.

Sa më lart, në kushtet kur është realizuar vërtetimi i periudhës së burgut në rrugë gjyqësore, sqarojmë se qytetari është informuar me shkresën nr.H-106/2, datë 07.11.2017 se struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë ka shqyrtuar aplikimin dhe ka përlllogaritur masën e dëmshpërblimit e cila do të dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave, me listën e radhës.

Nga ana tjetër, sjellim në vëmendjen tuaj se, Ministria e Drejtësisë dërgon për miratim jo vetëm një dosje/kërkesë në Këshillin e Ministrave, por të gjitha aplikimet për të cilat ka përfunduar shqyrtimi administrativ.

Së fundmi, ju bëjmë me dije se Ministria e Drejtësisë po përgatit dosjet e kompletuara për dërgimin për miratim të listës së radhës, në Këshillin e Ministrave.

Dëshirojmë të evidentojmë faktin se institucioni i Avokatit të Popullit nuk i ka vlerësuar rastet e trajtimit të dëmshpërblimit për ankuesit që paraqiten në institucion, si harresa apo si vonesa të qëllimshme nga struktura përgjegjëse e Ministrisë së Drejtësisë, por gjithashtu është i vetëdijshëm për verifikimet dhe procedurat e nevojshme ligjore që duhen ndjekur, si dhe për fondet e pamjaftueshme që janë në dispozicion për dëmshpërblimin e tyre.

Ndërkohë, është e rëndësishme të vlerësohen me prioritet dhe të dërgohen sa më parë për miratim në Këshillin e Ministrave ato dosje për të cilat janë mbyllur verifikimet dhe janë në pritje të miratimit të dëmshpërblimit me VKM. Përsheptimi i procesit është i domosdoshëm për këtë kategori, me qëllim shmangien e zvarritjeve të panevojshme në kohë dhe realizimin e të drejtave të tyre të mohuara ndër vite.

Në nenet 9 dhe 10 të ligjit nr.9831, datë 12.11.2007 përcaktohet:

*“Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: “Këshilli i Ministrave është autoriteti përgjegjës që miraton dëmshpërblimin financiar, në përputhje me këtë ligj, i cili, me vendim, përcakton gjenealitetet përkatëse të ish të dënuarit politik, llojin e dënimit, periudhën e plotë të vuajtjes së dënimit, gjithsej, në vite, muaj dhe ditë, sipas rastit, shumën e dëmshpërblimit financiar dhe, sipas rastit, gjenealitetet e sakta të familjarëve të viktimave të pushkatuara dhe masën përkatëse të dëmshpërblimit të tyre.*

*“1. Ministria e Drejtësisë është autoriteti përgjegjës që shqyrton kërkesat për përfitimin e dëmshpërblimit, sipas këtij ligji, në përputhje me rregullat e përcaktuara në kreun V të këtij ligji. Kur, pas shqyrtimit administrativ, rezulton se kërkesa është e drejtë dhe e bazuar në ligj, Ministria e Drejtësisë i propozon Këshillit të Ministrave miratimin e dëmshpërblimit.*

2. *Këshilli i Ministrave shqyrton propozimet e dërguara nga Ministria e Drejtësisë brenda dy javëve kalendarike. Vendimet hyjnë në fuqi menjëherë dhe botohen në Fletoren Zyrtare.*”

Nuk duhet harruar se edhe pse kanë kaluar 30 vjet nga shembja e sistemit komunist në Shqipëri, shoqëria shqiptare është ende e ndryshme ndaj kësaj periudhe të errët në historinë e saj. Regjimi komunist për gati gjysmë shekulli ka shkaktuar një numër të madh të viktimave në shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe në shkelje të rënda të ligjit ndërkombëtar humanitar. Kështu, duke mohuar shumë të drejta të njeriut, krijoi një sistem të gjerë të përndjekjes dhe burgosjes për të gjithë kundërshtarët politikë të regjimit.

Kampet dhe burgjet e vendosura në qytete të ndryshme të Shqipërisë, u bënë vendet e vuajtjeve të shumfishta për mijëra familje për vite me radhë gjatë 45 viteve të ish regjimit komunist.

Gjendja sociale në të cilën gjenden ish- të përndjekurit sot nuk është një gjendje për t'u marrë si model, por një gjendje varfërie. Ka mjaft probleme tek shtresa e ish-të përndjekurve politikë pavarësisht përpjekjeve të herëpashershme të strukturave shtetërore shqiptare për integrimin e shtresës së ish të përndjekurve.

Edhe pse për këtë shtresë janë miratuar disa ligje në Shqipëri, nga viti 1991 e deri tani, situata në të vërtetë është ndryshe, pasi ligjet nuk janë zbatuar në mënyrën më të mirë të mundshme. Në jo pak raste ato kanë krijuar edhe kundërthënie midis tyre dhe kjo shtresë sot është shumë larg integritit, sidomos në aspektin e dëmshpërblimit financiar, i cili është në proces.

Në vitin 2007, u miratua ligji nr.9831, datë 12.11.2007 *“Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”*, në zbatim të të cilit janë nxjerrë akte nënligjore, me qëllim miratimin e skemës së shpërndarjes për kompensimin e ish të dënuarve politikë të komunizmit.

Por, vihet re se procesi i kompensimit nuk ka përparuar me normat e dëshiruara, për arsye që lidhen kryesisht me mungesën e fondeve të nevojshme, por edhe me ndryshimet që ka pësuar legjislacioni përgjatë viteve dhe mospërcaktimin e një afati të arsyeshëm për përfundimin e tij.

Shteti shqiptar përmes rivendosjes së një shoqërie të lirë dhe demokratike, ka marrë përsipër angazhimin për krijimin e një sistemi ligjor në mbrojtje të të drejtave themelore të njeriut, ku shtetasve shqiptarë t'u jepet garancia e ushtrimit të këtyre të drejtave. Gjithashtu, këto të drejta duhet të njihen dhe realizohen nga shteti, brenda një afati të arsyeshëm, për të bërë të mundur përfitimin, në rastin konkret të dëmshpërblimeve.

Për gjithë sa parashtruam, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe të lirive nga administrata publike”*, si dhe në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, të ndryshuar, neni 21/b në të cilin parashikohet: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”*:

**REKOMANDOJMË:**

Marrjen e masave të nevojshme për dërgimin menjëherë për miratim në Këshillin e Ministrave të aktit nënligjor lidhur me aplikimin për dëmshpërblim të ish të dënuarit politik për të cilin ka përfunduar shqyrtimi administrativ, rasti i dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarin politik Sh.H.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar lutemi na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ermonela Ruspi**